



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 1339 Prot.

Vlorë, më 27 . 7 .2021.

VENDIM

Nr. 11 , datë 22 . 07 .2021

PROPOZIM PËR PËRFITIM PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 22.07.2021 në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, nenit 5 të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, pikës 4 dhe 5 të VKM - së Nr. 429, datë 12.09.2002 "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore" i ndryshuar, si dhe kërkesës së Z. Kastriot Rukaj për përfitim pensioni të posaçëm shtetëror, protokolluar me tonë Nr. 1211 Prot, datë 06.07.2021,

VENDOSI;

1. Ti propozojë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhënien e Pensionit të Posaçëm Shtetëror Zotit Kastriot Rukaj, për kontributin e shquar si trajner në sportin e Peshëngritjes me ekipin "Flamurtari" dhe Ekipin Kombëtar. I dalluar për përgatitjen e sportistëve cilësorë, me rezultate të larta në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari dhe Sektori i Urbanistikës, Zhvillimit të Territorit, Burimeve Njerëzore, Arsimit, Kulturës, Turizmit dhe Çështjeve Sociale në Këshillin e Qarkut Vlorë.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETARI
Ervis Moçka

Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë Nr. _____ Prot, datë _____ .2021.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

RELACION

Të Nderuar Këshilltarë!

Në mbështetje të nenit 5 të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe pikës 4 e 5 të VKM - së Nr. 429, datë 12.09.2002 "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore" i ndryshuar, Pensionin e Posaçëm Shtetëror e përfitojnë ata persona që:

- a) Kanë marrë pjesë në lëvizjen e Rilindjes Kombëtare, në lëvizjet popullore, në luftën kundër pushtuesve nazifashistë brenda dhe jashtë Shqipërisë, në mbrojtjen e kufirit e ruajtjen e integritetit territorial të Shqipërisë, në lëvizjen demokratike dhe që kanë merita të veçanta;
- b) Kanë arritur rezultate të dallueshme në fushën e shkencës, kulturës, arteve, ekonomisë dhe politikës;
- c) Kanë vuajtur nga persekutimi politik nën regjimin komunist.

Pensionin e Posaçëm Shtetëror e përfitojnë personat të cilët përmbushin kushtet e sipërpërmendura si shtesë mbi pensionin që u takon nga Sigurimet Shoqërore, ose si pension nëse nuk përfitojnë pension nga Sigurimet Shoqërore.

Në mbështetje të bazës ligjore të sipërpërmendur z. Kastriot Rukaj, i lindur më 12.12.1951 në Leskovik, Ersekë ka paraqitur kërkesë pranë institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë për përfitim Pensioni të Posaçëm Shtetëror.

Kërkesa drejtuar Këshillit të Qarkut Vlorë mbështetet në punën e palodhur, mundin dhe sakrificat e bëra për sportin e Peshëngritjes.

Për rreth 40 vite z. Rukaj ka edukuar brezat e rinj mbi edukimin fizik duke punuar si mësues i kësaj lënde si dhe ka stërvitur jo vetëm sportistët e talentuar vjonjat por edhe Ekipin Kombëtar.

Me punën e tij, lodhjen fizike si dhe dashurinë e transmetuar sportistëve për sportin e Peshëngritjes, ky sport njihet gjerësisht, pëlqehet nga publiku dhe është vlerësuar në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Rekordet dhe medaljet kombëtare dhe ndërkombëtare kanë bërë që ky sport dhe sportistët të cilët e ushtrojnë të radhiten ndër të parët në aktivitetet sportive, pas të cilëve qëndron një trajner profesionist si z. Kastriot Rukaj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Bashkëlidhur kërkesës gjendet dokumentacioni i mëposhtëm:

- Jetëshkrim i z. Kastriot Rukaj,
- Çertifikatë personale, me datë 28.06.2021,
- Çertifikatë familjare, me datë 18.06.2021,
- Vërtetim nga Dega e Sigurimeve Shoqërore Vlorë Nr. 1983 Prot, datë 28.06.2021,
- Fotokopje letër njoftimi elektronik,
- Kopje e noterizuar e Urdhërit "Mjeshtër i madh" dhënë nga Presidenti i Republikës (Nr. dekreti 13010, datë 09.04.2021) me motivacion "Në shenjë vlerësimi për kontributin e shquar si trajner në sportin e Peshëngritjes me ekipin "Flamurtari" dhe Ekipin Kombëtar. I dalluar për përgatitjen e sportistëve cilësorë, me rezultate të larta në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare".
- Kopje e noterizuar "Diplomë" dhënë nga Federata Shqiptare Qitje, Mundje, Ngritje peshe, Radioamatorizëm për vendin e I-rë (z. Kastriot Rukaj si trajner) në Kampionatin Kombëtar të Ngritjes së Peshave të rinj, Kat e I-rë, Shtator 1979.
- Kopje e noterizuar "Diplomë" dhënë nga Federata Shqiptare Qitje, Mundje, Ngritje peshe, Radioamatorizëm për vendin e I-rë (Ekipit Flamurtari) në Kampionatin Kombëtar të Ngritjes së Peshave të rinj, Kat e I-rë, Shtator 1979.
- Kopje e noterizuar "Diplomë" dhënë nga Federata Shqiptare Qitje, Mundje, Ngritje peshe, Radioamatorizëm për vendin e I-rë (z. Kastriot Rukaj si trajner) në Kampionatin Kombëtar të Ngritjes së Peshave të rinj, Shtator 1980.
- Kopje e noterizuar "Diplomë" dhënë nga Federata Shqiptare Qitje, Mundje, Ngritje peshe, Radioamatorizëm për vendin e I-rë (Ekipit Flamurtari) në Kampionatin Kombëtar të Ngritjes së Peshave të rinj, Shtator 1980.
- Kopje e noterizuar "Fletë Nderi", dhënë nga Klubi Sportiv Vlorë për rezultatet e arritura gjatë vitit 1980, Janar 1981.
- Kopje e noterizuar "Diplomë" dhënë nga Federata Shqiptare e Sporteve të Rënda për vendin e II-të (Ekipit Flamurtari) në Kupën e Republikës të rinj, Prill 1981.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

- Kopje e noterizuar "Diplomë" dhënë nga Federata Shqiptare e Sporteve të Rënda për vendin e II-të (z. Kastriot Rukaj si trajner) në Kupën e Republikës të rinj, Prill 1981.
- Kopje e noterizuar "Diplomë" dhënë nga Federata Shqiptare e Sporteve të Rënda dhe Qitjes për vendin e I-rë (z. Kastriot Rukaj si trajner) në Kampionatin Kombëtar të Ngritjes së Peshave të rinj, Tetor 1981.
- Kopje e noterizuar "Diplomë" dhënë nga Federata Shqiptare e Sporteve të Rënda dhe Qitjes për vendin e I-rë (Ekipit Flamurtari) në Kampionatin Kombëtar të Ngritjes së Peshave të rinj, Tetor 1981.
- Kopje e noterizuar "Diplomë" dhënë nga Federata Shqiptare e Sporteve të Rënda dhe Qitjes për vendin e III-të (z. Kastriot Rukaj si trajner), në Kupën e Republikës në Peshëngritje të rinj, Prill 1982.
- Kopje të noterizuara "Diplomë", dhënë nga Klubi Sportiv "Flamurtari" Vlorë për rezultatet e arritura gjatë vitit 1982 - 1983, Dhjetor 1982, Dhjetor 1983.
- Kopje e noterizuar "Diplomë" dhënë nga Federata Shqiptare e Sporteve të Rënda dhe Qitjes për vendin e III-të (Ekipit Flamurtari), në Kupën e Republikës në Peshëngritje të rinj, Prill 1982.
- Kopje e noterizuar "Diplomë" dhënë nga bashkimi i Federatës Shqiptare të Peshëngritjes, Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Solidariteti Olimpik Ndërkombëtar për pjesëmarrje në Kursin Kombëtar të Kualifikimit të Trajnerëve të Peshëngritjes, Dhjetor 2002.
- Kopje e noterizuar "Diplomë" dhënë nga Federata Shqiptare e Peshëngritjes për vendin e II-të (Ekipit Ismail Bej Vlora), në Kampionatin Kombëtar për të rinj, Prill 2003.
- Kopje e noterizuar "Diplomë" dhënë nga Federata Shqiptare e Peshëngritjes për vendin e III-të (Ekipit Ismail Bej Vlora), në Kampionatin U 17 vjeç , Qershor 2003.
- Kopje e noterizuar "Diplomë" dhënë nga Federata Shqiptare e Peshëngritjes për vendin e II-të (Ekipit Ismail Bej Vlora), në Kupën e Shqipërisë për të rinj, Korrik 2003.
- Kopje e noterizuar "Diplomë" dhënë nga Federata Shqiptare e Peshëngritjes për vendin e III-të (Ekipit Ismail Bej Vlora), në Kampionatin Kombëtar U 17 vjeç , Maj 2004.
- Kopje e noterizuar "Diplomë" dhënë nga Federata Shqiptare e Peshëngritjes për vendin e III-të (Ekipit Ismail Bej Vlora), në Kupën e Shqipërisë për të rritur, Shtator 2011.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

- Kopje e noterizuar "Diplomë" dhënë nga Federata Shqiptare e Peshëngritjes për vendin e II-të (Ekipit Ismail Bej Vlora), në Kampionatin Kombëtar U 17 vjeç, Korrik 2012.
- Kopje e noterizuar "Diplomë" dhënë nga Federata Shqiptare e Peshëngritjes për vendin e I-rë (Ekipit Ismail Bej Vlora), në Kampionatin Kombëtar të Peshëngritjes U 17 & U 20 vjeç Nëntor 2013.
- Kopje e noterizuar "Çertifikatë" dhënë nga Solidariteti Olimpik për pjesëmarrje në Kursin Teknik të Trajnerëve, Shkurt 2014.
- Kopje e noterizuar "Diplomë Mirënjohje" dhënë nga Federata Shqiptare e Peshëngritjes z. Rukaj me motivacionin "Krenaria e Peshëngritjes Shqiptare".

Duke u bazuar në kërkesën e z. Kastriot Rukaj, në zbatim të Ligjit Nr. 7703 datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të pikës 4 dhe 5 të VKM- së Nr. 429 datë 12.09.2002 "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore" i ndryshuar, mendojmë se kërkuesi plotëson kushtet për të përfituar këtë lloj pensioni.

Jurist

Alma Myrtaj